

STATUT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“PETALIS COSMETICS” SHPK

KREU 1
FORMA E ORGANIZIMIT-EMËRTIMI-THEMELUESIT-
SELIA-KOHËZGJATJA-OBJEKTI

NENI 1
Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Themelohet Shoqëria “Petalis Cosmetics” Shpk.
- 1.2 Shoqëria organizohet në formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.

NENI 2
Themeluesit

- 2.1 Ortakët themelues të Shoqërisë janë:
Hauard Malo, i biri i Muhametit, lindur më 23.12.1995 në Tiranë dhe banues po aty, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. BB9441725 dhe Nr. Personal J512230470.
Mariza Andoni, e bija e Eduardit, lindur më 09.02.1994 në Tiranë dhe banuese po aty, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e Pasaportës me Nr.BI6689701 dhe Nr.Personal J45209042D.

NENI 3
Selia

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në Rrugën “Lekë Dukagjini”, Pallati 11, Kati 2, Tiranë.
- 3.2 Shoqëria, në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj tregtare, mund të hapi degë të saj në të gjithë territorin e Shqipërisë.

NENI 4
Kohëzgjatja e Veprimtarisë

- 4.1 Shoqëria do ta ushtroj veprimtarinë e saj për një afat kohor të pakufizuar.

NENI 5
Objekti i Veprimtarisë

- 5.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e:
- Prodhimit të produkteve kozmetike.
 - Shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve kozmetike.

KREU II
KAPITALI DHE KUOTAT

NENI 6
Kapitali

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Lekë.

Udhëhiqës



- 6.2** Kapitali i Shoqërisë është i ndarë në dy kuota të cilat zotërohen nga ortakët themelues në raportet e mëposhtme:
Hauard Malo zotëron një kuotë e cila përfaqëson 80% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.
Mariza Andoni zotëron një kuotë e cila përfaqëson 20% të Kapitalit të Regjistruar të Shoqërisë.
- 6.3** E gjithë vlera e kontributeve të ortakëve për nënshkrimin e kapitalit të regjistruar, është në para.
- 6.4** E gjithë vlera e kapitalit të nënshkruar nga Ortakët, është shlyer prej tyre përpara regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 7

Zotërimi i Kuotave dhe Kalimi i tyre

- 7.1** Kuotat e Shoqërisë mund të zotërohen nga një ose më shumë persona. Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, marrëdhëniet ndërmjet bashkëzotëruesve të kuotës me Shoqërinë, rregullohen në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 7.2** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmes Shitblerjes, Trashëgimisë dhe Dhurimit.
- 7.3** Kalimi i kuotave përmes Shitblerjes kushtëzohet nga respektimi i të drejtës së parablerjes në favor të ortakëve të tjerë.
- 7.4** Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kalimi i kuotës përmes shitblerjes dhe dhurimit, gjenerohen që nga data e nënshkrimit të kontratës mes palëve.
- 7.5** Kuotat mund të pjestohen për shkak të kalimit të tyre.

KREU III

ORGANET E SHOQËRISË

NENI 8

Organet e Shoqërisë

- 8.1** Organet e Shoqërisë janë:
- Asambleja e Përgjithshme
 - Administratori

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 9

Asambleja e Përgjithshme

- 9.1** Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimarrës i Shoqërisë dhe përbëhet nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në kapital.

U. Alani



9.2 Cdo ortak ka të drejtë të mari pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme.

9.3 Cdo ortak në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

NENI 10

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

10.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për vendimarrjen mbi çështjet e mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- Ndryshimin e Statutit;
- Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- Investime që synojnë zhvillimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë si dhe format e mundshme të investimit;
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë;
- Cdo çështje tjetër të nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së Shoqërisë.
- Cdo çështje tjetër të kërkuar nga ortakët, vlera nominale e kuotave të të cilëve përfaqëson të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

NENI 11

Pjesëmarrja e Ortakëve në Mbledhjet e Asamblesë

11.1 Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblesë të Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

11.2 Ortaku mund të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme përmes Telekonferencës apo Video Konferencës ose me mjete elektronike të ngjajshme, me kusht që të gjithë të pranishmit të mund të identifikohen rregullisht dhe t'u jepet mundësia për të ndjekur diskutimet e mbledhjes dhe për të votuar për ato.

Adriani



NENI 12

Procedura e Thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1** Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori, sa herë që është e nevojshme për interesat e Shoqërisë. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme është e detyrueshme, në rastet e parashikuara nga neni 10 i këtij Statuti.
- 12.2** Ortakët, vlera nominale e kuotave të të cilëve përfaqëson të paktën 5% kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, mund t'i drejtojnë Administratorit një kërkesë me shkrim për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat Asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin vetë Asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me procedurën e parashikuar nga pika 1 e nenit 83 të Ligjit Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 12.3** Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Ortakëve të Shoqërisë pranë adresave të tyre të banimit apo të punës. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për Mbledhjen e Asamblesë.
- 12.4** Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas parashikimeve të kësaj dispozite, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 13

Mbajtja e Mbledhjes së Asamblesë

- 13.1** Si rregull mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në Selinë e Shoqërisë. Me pëlqimin e të gjithë ortakëve, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe në vende të tjera, të ndryshme nga selia e Shoqërisë.
- 13.2** Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari, i cili zgjidhet ndërmjet ortakëve të pranishëm apo të përfaqësuar në mbledhje. Nëse nuk kërkohet prania e një Noteri Publik, Asambleja e Përgjithshme duhet të emërojë një sekretar, i cili mund të jetë njëri prej ortakëve ose një person i tretë.
- 13.3** Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca të plota për të kontrolluar prokurat e përfaqësimit të ortakëve në Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, për të vlerësuar rregullshmërinë e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme si dhe për të vlerësuar nëse është arritur kuorumi i nevojshëm për vendimarrje.
- 13.4** Në rastet kur i gjithë kapitali i regjistruar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, vendimet e marra nga ortaku i vetëm duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen apo të fshihen.

NENI 14

Kuorumi i Nevojshëm për Vendimarrje



- 14.1** Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, vlera nominale e kuotave të të cilëve përfaqëson më shumë se 30% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Në këtë rast Asambleja merr vendim me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 14.2** Në rastin e vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, vlera nominale e kuotave të të cilëve përfaqëson më shumë se 50% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë. Në këtë rast Asambleja vendos me votat e 3/4 të votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 14.3** Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit në mbledhjen e saj të parë, ajo mund të mbledhet përsëri me të njëjtin rend dite brenda jo më shumë se 30 (tridhjet) dite pas mbledhjes së saj të parë, me të njëjtin rend dite.

NENI 15 **Marrja e Vendimeve**

- 15.1** Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, kur merr vendim për përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë, emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likujduesve, emërimin dhe shkarkimin e administratorëve, miratimin e shpërblimeve për të mësipërmit, miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë, përfaqësimit të shoqërisë në gjykatë dhe për çdo çështje tjetër për të cilën ky Statut apo Ligji Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, nuk kërkon një shumicë të cilësuar votash.
- 15.2** Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë të cilësuar votash, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, investime dhe format e tyre, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

ADMINISTRATORI

NENI 16 **Emërimi dhe Kompetencat e Administratorit**

- 16.1** Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë individë në pozitën e Administratorit të Shoqërisë. Administratori mund të zgjidhet nga rrethi i ortakëve të Shoqërisë.
- 16.2** Afati i emërimit të Administratorit nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet, me të drejtë rizgjedhje.
- 16.3** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- Kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;

U. Anani



- Përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Krijoj një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryej regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- Raportoј përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve të posaçme, me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryej detyra të tjera të përcaktuara në Ligj dhe në Statut.

16.4 Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet e mirëbesimit dhe standardet profesionale, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloj çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

16.5 Administrator i Shoqërisë "Petalis Cosmetics" Shpk emërohet Z.Hauard Malo, për një afat tre vjecar me të drejtë riemërimi.

NENI 17

DOKUMENTACIONI ZYRTAR I SHOQËRISË

17.1 Cdo shkresë, kërkesë, ankesë apo dokument tjetër ligjor apo financiar i Shoqërisë do të konsiderohet i rregullt nëse është nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë dhe mban vulën e saj.

17.2 Nëse Statuti, për dokumenta që lidhen me procedura ligjore dhe financiare të caktuara, për nënshkrimin e tyre nga Administratori kërkon edhe Autorizim nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, atëherë dokumentit i bashkëngjitet edhe Vendimi i Asamblesë që autorizon nënshkrimin nga Administratori.

NENI 18

Ndalimi i Konfliktit të Interesit

18.1 Administratori i Shoqërisë nuk mund të lidhë kontrata apo të hyjë në marrëdhënie të tjera me shoqërinë, nëse kjo nuk deklaron kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektit e interesit, e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej të gjithë ortakëve të Shoqërisë. Nëse Administrator është emëruar një prej ortakëve të Shoqërisë, ky nuk mund të marri pjesë në votimin e Asamblesë për dhënien e miratimit dhe kuota e tij nuk llogaritet për formimin e Kuorumit.

18.2 Miratimi i parashikuar në pikën 18.1 të këtij neni jepet gjithashtu për çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila

Handwritten signature

ka marrëdhënie personale apo financiare me Administratorin e Shoqërisë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me Administratorin janë të tilla që në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tij në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërme me Administratorin e Shoqërisë:

a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/ bashkëshortes;

b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;

c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuar, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;

ç) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.

18.3 Çdo veprim që kërkon miratim sipas këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.

18.4 Në rast se vërtetohen raste të konfliktit të interesit sipas këtij neni, Administratori ngarkohet të dëmshpërblej Shoqërinë me dëmin efektiv dhe fitimin e munguar të shkaktuar.

NENI 19 **Sekreti Tregtar**

19.1 Administratori i Shoqërisë është përgjegjës për ruajtjen e Sekretit Tregtar për të cilin është vënë në dijeni për shkak të detyrës.

19.2 Përbën Sekret Tregtar çdo e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron në mënyra të përshtatshme, i cili nëse do t'u përhapej personave të paautorizuar, do t'i shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë.

NENI 20 **Eksperti Kontabël i Autorizuar**

20.1 Auditimi i brendshëm i Shoqërisë realizohet nga një apo më shumë ekspertë kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, për një vit financiar.

20.2 Eksperti Kontabël i Autorizuar emërohet nga Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.

20.3 Ekspert Kontabël i Shoqërisë emërohet Shoqëria "TPA Group" Shpk, për një afat dy vjeçar.

U. Anani

[Signature]

**KREU IV
BILANCI**

NENI 21

Bilanci i Shoqërisë dhe Shpëndarrja e Fitimit

- 21.1** Brenda 2 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme miraton pasqyrat financiare vjetore të vitit paraardhës dhe vendos për shpërndarjen e fitimeve të mbetura pas mbulimit të humbjeve ushtrimore dhe krijimit të rezervave të detyrueshme sipas ligjit.
- 21.2** Me një Vendim të marrë me shumicë të cilësuar votash, Asambleja e Ortakëve mund të vendos që fitimi i mbetur pas mbulimit të humbjeve dhe krijimit të rezervave, të mos shpërndahet te ortakët, por të përdoret për qëllime të tjera që i shërbejnë zhvillimit të veprimtarisë së Shoqërisë.

NENI 22

Shpenzimet përpara Themelimit të Shoqërisë

- 22.1** Përpara themelimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, ka lindur nevoja e përballimit të disa shpenzimeve që lidheshin në objektin e veprimtarisë së Shoqërisë që do të themelohej nga ortakët.
- 22.2** Vlera e Shpenzimeve të realizuara përpara themelimit dhe regjistrimit të Shoqërisë janë:
- 12,475 EUR
 - 16,730 Dollar
 - 991,546 Leke
- 22.3** Shoqëria njeh dhe pranon që të gjitha shpenzimet e përcaktuara në Pikën 22.2 të këtij Neni janë përballuar nga Ortaku Huard Malo.
- 22.4** Ortakët e Shoqërisë pranojnë të drejtën kreditore që Z.Huard Malo ka ndaj Shoqërisë. Ortakët bien dakort që Shoqëria nuk do të shpërndaj dividend deri në shlyerjen tërësore të detyrimit që Shoqëria ka ndaj Ortakut Huard Malo.

NENI 23

Prishja e Shoqërisë

- 23.1** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të vendos për prishjen e Shoqërisë për shkaqet e parashikuara nga neni 99 paragrafi 1 i Ligjit Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 23.2** Administratori i Shoqërisë është përgjegjës për regjistrimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme për Prishjen e Shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe ç'regjistrimin e Shoqërisë pranë Organeve Tatimore dhe Organit të Qeverisjes Vendore.
- 23.3** Me përjashtim të rasteve kur prishja e Shoqërisë kërkon kalimin e saj në procedurat e falimentimit, prishja e Shoqërisë e vendosur me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme ka si pasojë nisjen e procedurave të likuidimit.



23.4 Likuidimi i Shoqërisë kryhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.9901, Datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.


NENI 24

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve


- 24.1** Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin në lidhje me interpretimin apo zbatimin e këtij Statuti, kompetente do të jetë Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.
- 24.2** Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe Ortakëve të saj, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKËT

Hauard Malo



Mariza Andoni



Nënshkruar në 2 (dy) kopje me vlerë të njëjtë, sot më Datë 16.10.2019.